	<p>datën ose datat përkatëse; dhe d) çdo konvertim ose modifikim që i është bërë një arme zjarri dhe që çon në ndryshim të kategorisë ose nënkategorisë së saj, duke përfshirë shkatërrimin ose çaktivizimin e certifikuar të armës si dhe datën ose datat përkatëse.</p> <p>Vendet anëtare garantojnë se të dhënat për armët e zjarrit dhe pjesët kryesore, përfshirë të dhënat personale përkatëse, mbahen në sistemet e ruajtjes së të dhënave nga autoritetet kompetente për një periudhë prej 30 vitesh pas shkatërrimit të armëve të zjarrit ose pjesëve kryesore në fjalë. Të dhënat për armët e zjarrit dhe</p>				<p>armës së zjarrit ose pjesëve kryesore në fjalë.</p> <p>6. Të dhënat personale fshihen nga sistemi i ruajtjes së të dhënave pas përfundimit të periudhave të specifikuara në paragrafin “a” dhe “b”, të pikës 5, të këtij neni. Kjo do të bëhet pa cenuar rastet ku të dhëna personale specifike janë transferuar te një autoritet kompetent për parandalimin, hetimin, zbulimin ose ndjekjen penale të veprave penale ose ekzekutimin e dënimeve penale dhe përdoren në atë kontekst specifik, ose tek autoritete të tjera kompetente për një qëllim të përshtatshëm të parashikuar nga legjislacioni i brendshëm. Në këto raste, përpunimi i këtyre të dhënave nga autoritetet kompetente, do të rregullohet nga legjislacioni i ligjit për mbrojtjen e të dhënave.</p> <p>7. Tregtarët e armëve të zjarrit e të gjahut janë të detyruar të mbajnë regjistër ku të regjistrohet çdo armë zjarri dhe pjesë kryesore që është objekt i këtij ligji dhe që merret ose asgjësohet prej tyre, së bashku me detajet që mundësojnë identifikimin dhe gjurmimin e armës së zjarrit ose pjesëve kryesore, në veçanti të llojit, markës, modelit, kalibrit dhe numrit të serisë si dhe emrat dhe adresat e furnizuesve dhe të blerësve.</p> <p>Pas përfundimit të aktiviteteve të tyre, tregtarët dhe ndërmjetësit do ta dorëzojnë atë regjistër tek organi përgjegjës i policisë, përgjegjëse për sistemet e ruajtjes së të dhënave.</p>		
--	---	--	--	--	---	--	--

	<p>pjesët kryesore të përmendura në nënparagrafin e parë të këtij paragrafi, si dhe të dhënat personale përkatëse mund të aksesohen:</p> <p>a) nga autoritetet kompetente për lëshimin ose revokimin e autorizimeve të përmendura në nenin 6 ose 7, ose nga autoritetet kompetente për procedurat doganore, për një periudhë prej 10 vitesh pas shkatërrimit të armës së zjarrit ose pjesëve kryesore në fjalë; dhe</p> <p>b) nga autoritetet kompetente për parandalimin, hetimin, zbulimin ose ndjekjen penale të veprave penale ose ekzekutimin e dënimeve penale, për një periudhë prej 30 vitesh pas shkatërrimit të</p>				<p>8. Tregtarët dhe ndërmjetësit detyrohen t'i raportojnë organit përgjegjës të policisë, pa vonesa të pajustificuara, transaksionet që përfshijnë armët e zjarrit ose pjesët kryesore dhe municionet. Komunikimi i tregtarëve dhe ndërmjetësve bëhet në formë të shkruar ose elektronike.</p> <p>9. Rregullat për krijimin, funksionimin dhe administrimin e regjistrit elektronik të armëve, pjesëve kryesore dhe municioneve, miratohen nga Këshilli i Ministrave.</p>		
--	---	--	--	--	---	--	--

	<p>armës së zjarrit ose pjesëve kryesore në fjalë. Vendet anëtare garantojnë se të dhënat personale fshihen nga sistemi i ruajtjes së të dhënave pas përfundimit të periudhave të specifikuara në nënparagrafin e dytë dhe të tretë. Kjo do të bëhet pa cenuar rastet ku të dhëna personale specifike janë transferuar te një autoritet kompetent për parandalimin, hetimin, zbulimin ose ndjekjen penale të veprave penale ose ekzekutimin e dënimeve penale dhe përdoren në atë kontekst specifik, ose tek autoritete të tjera kompetente për një qëllim të përshtatshëm të parashikuar nga legjislacioni i brendshëm. Në këto raste, përpunimi i këtyre të dhënave nga autoritetet kompetente, do të</p>						
--	---	--	--	--	--	--	--

	<p>rregullohet nga legjislacioni i brendshëm i vendeve anëtare përkatëse, në përputhje të plotë me ligjin e BE-së, veçanërisht me ligjin për mbrojtjen e të dhënave. Përgjatë periudhës së tyre të aktivitetit, tregtarëve dhe ndërmjetësve do t'ju kërkohet që të mbajnë një regjistër ku do të regjistrohet çdo armë zjarri dhe pjesë kryesore që është objekt i kësaj Direktive dhe që merret ose asgjësohet prej tyre, së bashku me detajet që mundësojnë identifikimin dhe gjurmimin e armës së zjarrit ose pjesëve kryesore, në veçanti të llojit, markës, modelit, kalibrit dhe numrit të serisë si dhe emrat dhe adresat e furnizuesve dhe të blerësve. Pas përfundimit të</p>						
--	--	--	--	--	--	--	--

	<p>aktiviteteve të tyre, tregtarët dhe ndërmjetësit do ta dorëzojnë atë regjistër tek autoritetet kombëtare përgjegjëse për sistemet e ruajtjes së të dhënave të parashikuara në nënparagrafin e parë.</p> <p>Vendet anëtare garantojnë që tregtarët dhe ndërmjetësit e vendosur në territorin e tyre t'i raportojnë autoriteteve kompetente kombëtare, pa vonesa të pajustificuara, transaksionet që përfshijnë armët e zjarrit ose pjesët kryesore, që tregtarët dhe ndërmjetësit të kenë një komunikim elektronik me këto autoritete për këto qëllime raportimi dhe që sistemet e ruajtjes së të dhënave të përditësohen</p>						
--	---	--	--	--	--	--	--

	menjëherë pas marrjes së informacionit në lidhje me këto transaksione 5. Vendet anëtare garantojnë se të gjitha armët e zjarrit mund të lidhen me zotëruesit e tyre në çdo moment.						
Neni 4 Paragrafët 3,	3. Çdo vend anëtar vendos një sistem për rregullimin e aktiviteteve të tregtarëve dhe ndërmjetësve. Këto sisteme do të përfshijnë të paktën masat në vijim: a) regjistrimin e tregtarëve dhe ndërmjetësve që veprojnë brenda territorit të vendit anëtar; b) licencimin ose autorizimin e aktiviteteve të tregtarëve dhe ndërmjetësve brenda territorit të vendit anëtar; dhe c) një kontroll të integritetit profesional dhe privat si dhe të		Projektligji “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 74/2014 “Për armët””	Neni 11	Licencimi i veprimtarive të lejuara me armë do të përfshijnë të paktën masat në vijim: a) regjistrimin e tregtarëve dhe ndërmjetësve që veprojnë brenda territorit të Republikës së Shqipërisë; b) licencimin ose autorizimin e aktiviteteve të tregtarëve dhe ndërmjetësve brenda territorit të Republikës së Shqipërisë; dhe c) një kontroll të integritetit profesional dhe privat si dhe të aftësive përkatëse të tregtarit ose ndërmjetësit në fjalë. Në rastin e njëpersoni juridik, kontrolli do të kryhet si mbi subjektin juridik, ashtu dhe mbi personin ose personat fizikë që menaxhojnë sipërmarrjen”.	Plotësisht i përputhur	

	aftësive përkatëse të tregtarit ose ndërmjetësit në fjalë. Në rastin e një personi juridik, kontrolli do të kryhet si mbi subjektin juridik ashtu dhe mbi personin ose personat fizikë që menaxhojnë sipërmarrjen.'					
<p>DIREKTIV ËN 2017/853/K E TË PARLAMENTIT EVROPIAN DHE TË KËSHILLIT të datës 17 maj 2012</p> <p>Neni 10 germa "b" Paragrafët 1-3</p>	<p>1. Vendet anëtare marrin masa për çaktivizimin e armëve të zjarrit që duhet të verifikohen nga autoriteti kompetent në mënyrë që të garantohet që modifikimet e kryera në armët e zjarrit i bëjnë të gjitha pjesët kryesore të tyre përfundimisht jofunksionale dhe të pamundura për t'u hequr, zëvendësuar ose modifikuar në mënyrë të tillë që do të mundësonte riaktivizimin e mundshëm të</p>		<p>Projektligji "Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 74/2014 "Për armët"”</p>	<p>Neni 16 18.1</p>	<p>Licenca për çaktivizimin e armëve të zjarrit për përdorim civil</p> <ol style="list-style-type: none"> 1. Për veprimtarinë e çaktivizimit të armëve të zjarrit që përfshihen në fushën e veprimit të këtij ligji, lëshohet licencë nga organi përgjegjës në Policinë e Shtetit. 2. Licenca për këto veprimtari i jepet çdo subjekti juridik ose fizik që plotëson kushtet dhe kriteret, sipas këtij ligji dhe akteve nënligjore. Procesit të çaktivizimit i nënshtrohen armët në pronësi të personave juridik e fizik me kërkesën e tyre, për t'i mbajtur në pronësi si relike. 3. Standardet dhe teknikat e çaktivizimit për të garantuar që të gjitha pjesët kryesore të këtyre 	

	<p>armëve të zjarrit. Në kontekstin e këtij verifikimi, vendet anëtare parashikojnë lëshimin e një vërtetimi dhe regjistrimin e dokumentit të çaktivizimit të armës së zjarrit dhe vendosjen e një shenje lehtësisht të dukshme në armën e zjarrit për këtë qëllim.</p> <p>2.Komisioni miraton aktet zbatuese që përcaktojnë standardet dhe teknikat e çaktivizimit për të garantuar që të gjitha pjesët kryesore të këtyre armëve të zjarrit të bëhen përfundimisht jofunkionale dhe të pamundura për t'u hequr, zëvendësuar ose modifikuar në një mënyrë të tillë që do të mundësonte riaktivizimin e mundshëm të armëve të zjarrit.</p>				<p>armëve të zjarrit të bëhen përfundimisht jofunkionale dhe të pamundura për t'u hequr, zëvendësuar ose modifikuar në një mënyrë të tillë, që do të mundësonte riaktivizimin e mundshëm të armëve të zjarrit, përcaktohen në rregulloren e miratuar nga ministri.</p> <p>4. Çaktivizimi i armëve të zjarrit kontrollohet nga autoriteti kompetent, në mënyrë që të garantohet që modifikimet e kryera në armët e zjarrit i bëjnë të gjitha pjesët kryesore të tyre përfundimisht jofunkionale dhe të pamundura për t'u hequr, zëvendësuar ose modifikuar. Kontrolli shoqërohet me lëshimin e një vërtetimi të armës së zjarrit të çaktivizuar dhe vendosjen e markimit për këtë qëllim.</p>		
--	--	--	--	--	--	--	--

	<p>Këto akte zbatuese miratohen në përputhje me procedurën e shqyrtimit të përmendur në nenin 13, germa "b", paragrafi 2.</p> <p>3. Aktet zbatuese të përmendura në paragrafin 2 nuk zbatohen për armët e zjarrit të çaktivizuara përpara datës së zbatimit të këtyre akteve zbatuese, përveç rastit kur këto armë zjarri transferohen në një tjetër vend anëtar ose vendosen në treg pas kësaj date.</p>						
Neni 5, germa "b"	Vendet anëtare duhet të garantojnë që, në rastet që përfshijnë blerjen dhe shitjen e armëve të zjarrit, pjesëve kryesore ose municioneve të klasifikuara në kategorinë A, B ose C përmes kontratave të shitjes në distancë të përcaktuara në pikën 7 të nenit 2 të		Projektligji "Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 74/2014 "Për armët"	Neni 16 18.2	<p>Licenca për import dhe tregtimin e armëve të gjahut, sportive, pjesëve kryesore dhe municioneve të tyre</p> <ol style="list-style-type: none"> 1. Për veprimtarinë e importit dhe tregtimin e armëve të gjahut, sportive pjesëve kryesore dhe municioneve të tyre, që përfshihen në fushën e veprimit të këtij ligji, lëshohet licencë nga organi përgjegjës në Policinë e Shtetit. 2. Licenca për këtë veprimtari i jepet çdo subjekti juridik ose fizik që plotëson kushtet dhe kriteret, sipas këtij ligji dhe akteve nënligjore. 	Plotësisht i përputhur	

	<p>Direktivës 2011/83/BE të Parlamentit Evropian dhe të Këshillit (*), identiteti, dhe kur është e nevojshme, autorizimi i blerësit të armës së zjarrit, pjesëve kryesore ose municionit kontrollohen përpara, ose të paktën menjëherë në momentin që i dorëzohen atij personi, nga:</p> <p>a) një tregtar ose ndërmjetës i licencuar ose autorizuar; ose</p> <p>b) një autoritet publik ose përfaqësuesi i atij autoriteti</p>				<p>3. Kushtet e sigurisë së objektit që duhet të plotësohen për veprimtari përcaktohen në rregulloren e miratuar nga Ministri.</p>		
<p>Rregullore (BE) nr. 258/2012 e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit, datë 14 mars 2012</p> <p>Neni 8</p>	<p>1. Për qëllime gjurmimi, autorizimi për eksport dhe licenca e importit ose autorizimi i importit i lëshuar nga vendi i tretë importues si dhe dokumentacioni shoqërues duhet të përmbajnë së bashku</p>		<p>Projektligji “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 74/2014 “Për armët””</p>	<p>Neni 19</p>	<p>Autorizimi i importit</p> <p>1. Për qëllime gjurmimi, autorizimi për eksport dhe licenca e importit ose autorizimi i importit si dhe dokumentacioni shoqërues duhet të përmbajnë së bashku informacionet që përfshijnë:</p> <p>a) datën e lëshimit të certifikatës;</p> <p>b) vendin e lëshimit;</p> <p>c) vendin e eksportit;</p> <p>d) vendin e importit;</p>	<p>Plotësisht i përputhur</p>	

	<p>informacionet që përfshijnë:</p> <p>a) datën e lëshimit të certifikatës;</p> <p>b) vendine lëshimit;</p> <p>c) vendin e eksportit;</p> <p>d) vendin e importit;</p> <p>e) sipas rastit, vendin ose vendet e treta të transitit;</p> <p>f) marrësin;</p> <p>g) marrësi fundor, nëse dihet në kohën e dërgesës;</p> <p>h) të dhënat që mundësojnë identifikimin e armëve të zjarrit, pjesëve dhe komponentëve kryesorë të tyre dhe municioneve, si dhe sasinë e tyre, duke përfshirë, të paktën para dërgimit, markimin e vendosur në armët e zjarrit.</p>				<p>e) sipas rastit, vendin ose vendet e treta të transitit;</p> <p>f) marrësin;</p> <p>g) marrësi fundor, nëse dihet në kohën e dërgesës;</p> <p>h) të dhënat që mundësojnë identifikimin e armëve të zjarrit, pjesëve dhe komponentëve kryesorë të tyre dhe municioneve, si dhe sasinë e tyre, duke përfshirë, të paktën para dërgimit, markimin e vendosur në armët e zjarrit.</p>		
<p>Rregullore (BE) nr. 258/2012 e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit, datë 14 mars 2012</p>	<p>1. Procedurat e thjeshtësuara për eksportin e përkohshëm ose riekportin e armëve të zjarrit, pjesëve dhe komponentëve kryesorë të tyre dhe</p>		<p>Projektligji “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 74/2014 “Për armët””</p>	<p>Neni 20</p>	<p>Transferim i perkohshem i armëve dhe municioneve të tyre</p> <p>1. Procedurat e thjeshtësuara për eksportin e përkohshëm ose riekportin e armëve të zjarrit, pjesëve dhe komponentëve kryesorë të tyre dhe municioneve zbatohen si më poshtë:</p>	<p>Plotësisht i përputhur</p>	

<p>Neni 9</p>	<p>municioneve zbatohen si më poshtë: a) Nuk kërkohet autorizim për eksport për: I.eksportin e përkohshëm nga gjuetarët ose qitësit sportivë si pjesë e objekteve të tyre personale shoqëruese, gjatë një udhëtimi në një shtet të tretë, me kusht që t'i vërtetojnë autoriteteve kompetente arsyet e udhëtimit, veçanërisht duke treguar ftesën ose provë tjetër të aktiviteteve të gjuetisë ose sportive në vendin e tretë të destinacionit, të: - një ose më shumë arme zjarri, - komponentëve kryesorë të tyre, nëse janë të markuar, si edhe të pjesëve, - municioneve që lidhen me to, me një kufizim prej maksimumi 800 fishekë për</p>				<p>Policia e Shtetit pajis me autorizim të perkohshem për import dhe eksport gjuetarët ose qitësit sportivë si pjesë e objekteve të tyre personale shoqëruese, gjatë një udhëtimi në një shtet të tretë ose hyrjes në republikën e Shqipërisë me kusht që t'i vërtetojnë autoriteteve kompetente arsyet e udhëtimit, veçanërisht duke treguar ftesën ose provë tjetër të aktiviteteve të gjuetisë ose sportive në vendin e tretë të destinacionit, të:</p> <ol style="list-style-type: none"> a) një ose më shumë arme zjarri, b) komponentëve kryesorë të tyre, nëse janë të markuar, si edhe të pjesëve, c) municioneve që lidhen me to, me një kufizim prej maksimumi 800 fishekë për gjuetarët dhe maksimumi 1200 fishekë për qitësit sportivë; 		
---------------	--	--	--	--	--	--	--

	gjuetarët dhe maksimumi 1200 fishekë për qitësit sportivë;						
			Projektligji “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 74/2014 “Për armët””	Neni 21	Transiti i mallrave armëve të zjarrit, pjesëve përbërëse dhe municioneve të tyre Transiti i mallrave armëve të zjarrit, pjesëve përbërëse dhe municioneve të tyre në rrugë tokësore apo ujore, nga dogana/pika e hyrjes deri në doganë/pikën e daljes, realizohet bazuar te licenca e lëshuar nga Autoriteti i Kontrollit Shtetëror të Eksporteve.		
Rregullore (BE) nr. 258/2012 e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit, datë 14 mars 2012 Neni 15	Për të siguruar zbatimin e duhur të kësaj rregulloreje, shtetet anëtare marrin masat e nevojshme dhe proporcionale për t'u mundësuar autoriteteve të tyre kompetente që të: a) mbledhin informacion për çdo porosi ose transaksion që përfshin armë zjarri, pjesët dhe komponentët kryesore të tyre dhe		Projektligji “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 74/2014 “Për armët””	Neni 22	Neni 23 ndryshohet si më poshtë: 1. Ushtrimi nga personat fizikë dhe juridikë i veprimtarisë së licencuar/autorizuar, i nënshtrohet inspektimit të rregullt nga organi përgjegjës i Policisë së Shtetit, gjatë të cilit zbatohen dispozitat e ligjit për inspektimin në Republikën e Shqipërisë dhe dispozitat e tjera të zbatueshme në fuqi. 2. Policia e shtetit autorizon inspektimin e subjekteve fizikë e juridikë, tëmbikqyrë përmbushjen e detyrimeve për zbatim të ligjit, përfshirë masat e sigurisë, shitjen dhe blerjen e armëve, pjesëve kryesore e municioneve, trajnimin dhe pajisjen e personave fizikë me dëshminë e aftësisimit teorik e	Plotësisht i përputhur	

	<p>municionet; dhe</p> <p>b) përcaktojnë se masat e kontrollit të eksportit janë zbatuar siç duhet, gjë që mund të përfshijë në veçanti kompetencën për të hyrë në ambientet e personave që janë të interesuar në një transaksion eksporti.</p>				<p>praktik të armëve, mbajtjen e regjistrave, shitjen e municioneve, rregullat erregjistrimit të shtetasve në poligone.</p> <p>3. Personat fizik/juridik të autorizuar/licencuarjanë të detyruar të mundësojnë kryerjen e mbikqyrjes, të kontrollit të armëve dhe municionit, t'ë vënë në dispozicion dokumentacionin përkatës dhe t'ë ofrojnë të dhënat dhe njoftimet e nevojshme. Kjo përfshin të drejtën e organit kompetent të hyjë në hapësirat ku kryhet aktiviteti me armë, pjesë të armëve dhe municionit”.</p>		
<p>DIREKTIV ËN 2017/853/K E TË PARLAME NTIT EVROPIA N DHE TË KËSHILLI T të datës 17 maj 2012</p> <p>Neni 5a</p>	<p>Për të minimizuar rrezikun që armët e zjarrit dhe municionet të aksesohen nga persona të paautorizuar, shtetet anëtare vendosin rregulla lidhur me mbikëqyrjen e duhur të armëve të zjarrit dhe municioneve, si dhe rregulla për ruajtjen e duhur në mënyrë të sigurt. Armët e zjarrit dhe municionet e tyre nuk duhet të jenë lehtësisht të</p>		<p>Projektligji “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 74/2014 “Për armët””</p>	<p>Neni 26</p>	<p>“5. Ndalohet mbajtja me vete e armëve për alarm e për sinjalizim me dritë, armëve pneumatike (ajrore), armëve të ftohta, paralizuesit elektrikë jashtë destinacionit për të cilat janë blerë. Shkelja në këtë rast konsiderohet armëmbajtje pa leje dhe penalizohet sipas ligjit.</p> <p>“6 Ish-Punonjësit e Policisë së Shtetit, që me ligj kanë në pronësi private armë zjarri, u lejohet ta mbajnë armën në lëvizje”.</p>	<p>Plotësisht i përputhur</p>	

	<p>aksesueshme së bashku. Mbikëqyrje e duhur do të thotë që personi që disponon në mënyrë të ligjshme armën e zjarrit ose municionin në fjalë gëzon kontroll mbi të gjatë transportit ose përdorimit. Niveli i shqyrtimit të imtësishëm i këtyre masave të ruajtjes së duhur duhet të pasqyrojë numrin dhe kategorinë e armëve të zjarrit dhe municioneve në fjalë.</p>						
<p>DIREKTIV ËN 2017/853/K E TË PARLAME NTIT EVROPIA N DHE TË KËSHILLI T të datës 17 Maj 2012</p> <p>Neni 5 Paragrafi 1</p>	<p>Pa cenuar nenin 3, vendet anëtare lejojnë blerjen dhe mbajtjen e armëve të zjarrit vetëm nga persona që kanë arsye të vlefshme dhe të cilët:</p> <p>a) janë të paktën 18 vjeç, në veçanti në lidhje me blerjen dhe mbajtjen e armëve të zjarrit për gjueti dhe qitje, por me kushtin që</p>		<p>Projektligji “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 74/2014 “Për armët””</p>	<p>Neni 30</p>	<p>Në nenin 34 bëhen këto ndryshime:</p> <p>Personi që është përfitues i një prej llojeve të autorizimeve, sipas parashikimeve të këtij ligji, duhet të plotësojë këto kritere:</p> <p>a) të jetë shtetas shqiptar;</p> <p>b) të ketë mbushur moshën 22 vjeç;</p> <p>c) të mos ketë qenë i dënuar më parë me vendim të formës së prerë për vepra penale të kryera me dashje;</p> <p>ç) të mos jetë i evidentuar për veprimtari</p>	<p>Plotësisht i përputhur</p>	

	<p>në rastin e personave nën 18 vjeç, duke përjashtuar blerjen, ata të kenë lejen e prindit ose të jenë nën mbikëqyrjen e prindërve, ose nën mbikëqyrjen e një të rrituri me autorizim të vlefshëm për armë zjarri ose për gjueti, ose të jenë brenda një qendre trajnimi të licencuar ose të miratuar ndryshe, dhe prindi ose një i rritur me autorizim të vlefshëm për armë zjarri ose për gjueti merr përsipër përgjegjësinë për ruajtjen e duhur në përputhje me nenin 5 germa "a"; dhe</p> <p>b) nuk kanë gjasa të përbëjnë rrezik për veten ose për të tjerët, për rendin publik ose sigurinë publike; fakti që mund të jenë dënuar për një krim të rëndë të paramenduar duhet të konsiderohet si tregues i këtij</p>				<p>kriminale, për raste të kundërshtimit me dhunë ndaj punonjësve të Policisë së Shtetit, nëpunësit publik ose për veprat penale të dhunës në familje, për çështje me objekt të hakmarrjes ose gjakmarrjes;</p> <p>d) të mos jetë revokuar licenca/autorizimi me një afat jo më të vogël se 3 vite.</p>		
--	---	--	--	--	---	--	--

	rreziku.						
<p>DIREKTIV A E KËSHILLI T "Për kontrollin e blerjeve dhe mbajtjen e armëve" (91/477/KE E)</p> <p>Neni 7 pika 3</p> <p>DIREKTIV ËN 2008/51/KE TË PARLAME NTIT EVROPIA N DHE TË KËSHILLI T të datës 21 maj 2008</p> <p>Neni 7 pika 5</p>	<p>3. Autorizimi për blerjen dhe posedimin e një arme zjarri të kategorisë B mund të jenë në formën e një vendimi të vetëm administrativ.</p> <p>5. Vendet anëtare miratojnë rregulla për të garantuar se personat që mbajnë autorizime për armë zjarri të kategorisë B të parashikuara në legjislacionin e brendshëm, nga data 28 korrik 2008, nuk kanë nevojë të aplikojnë për licencë ose leje për armët e kategorisë C dhe D që kanë në zotërim, për shkak të hyrjes në fuqi të Direktivës 2008/51/KE të Parlamentit</p>	<p>Projektligji "Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 74/2014 "Për armët"</p>	<p>Neni 31</p>	<p>Në nenin 38, ndryshon me këtë përmbajtje: "1.Kërkesa për lëshimin e autorizimit për blerje dhe mbajtje arme, që përfshihen në kategoritë "B" dhe "C", sipas këtij ligji, miratohet me akt administrativ. 2. Autorizimi për mbajtje arme zjarri lëshohet nga struktura vendore e policisë, sipas formatit të miratuar, kundrejt pagesës së tarifës me afat 5 vjeçar. 3. Personat që mbajnë autorizime për armë zjarri të kategorisë "B" të parashikuara në këtë ligj, nuk kanë nevojë të aplikojnë për autorizim blerje për armët e kategorisë "C", por pajisen me autorizim blerje nga komisioni përgjegjës, pas kërkesës së personit në njësinëpërgjegjëse të policisë.</p>	<p>Plotësisht i përputhur</p>		

<p>DIREKTIV ËN 2017/853/K E TË PARLAME NTIT EVROPIA N DHE TË KËSHILLI T të datës 17 Maj 2012</p> <p>Neni 7 pika a</p>	<p>Evropian dhe të Këshillit, datë 21 maj 2008. Megjithatë çdo transferim i mëtejshëm i armëve të zjarrit të kategorive C ose D do të jetë objekt i marrësit që merr ose ka një licencë ose që ka leje specifike për të mbajtur këto armë</p> <p>"Autorizimet për posedimin e armëve të zjarrit rishikohen periodikisht, në intervale kohore jo më të gjata se 5 vjet. Një autorizim mund të rinovohet ose zgjatet në qoftë se kushtet mbi bazën e të cilave është dhënë janë ende të përmbushura</p> <p>...gjuetarët dhe aktoret e dokumenteve</p>				<p>4. Autorizimet e parashikuara në këtë ligj rishikohen periodikisht, në intervale jo më të gjata se 5 vite.</p> <p>5. Personat fizik për nevoja të sigurisë fizike, kanë të drejtë të pajisen vetëm me një armë zjarri të shkurtër gjysmëautomatike dhe me 50 fishekë për armë.</p> <p>6. Personat fizikë për nevoja të gjuetisë, kanë të drejtë të pajisen me armë gjahu:</p> <p>a) një arme gjahu me vjaska;</p> <p>b) një armë gjahu gjysmëautomatike;</p>	<p>Plotësisht i përputhur</p> <p>Plotësisht i përputhur</p>	
--	---	--	--	--	---	---	--

<p>Neni 12</p>	<p>historike, në lidhje me armët e zjarrit të klasifikuara në kategorinë C dhe qitsit, në lidhje me armët e zjarrit të klasifikuara në kategorinë B ose C dhe armët e zjarrit të klasifikuara në kategorinë A për të cilat është dhënë një autorizim sipas nenit 6 (6) ose për të cilat autorizimi është konfirmuar, rinovuar ose zgjatur sipas nenit 7 (4a) pa autorizimin paraprak të përmendur në Nenin 11 (2), të ketë në posedim një ose më shumë armë zjarri gjatë një udhëtimit nëpër dy ose më shumë Shtete Anëtare me qëllim të përfshirjes në aktivitetet e tyre, me kusht që:</p>				<p>c) një armë gjahu me përseritje; ç) një armë gjahu çifte; d) një armë gjahu tek;</p> <p>6.1 Personat fizik që kërkojnë të pajisen me armë mbi numrin e lëjuar në pikën 6 të këtij neni, detyrohen të paguajnë 10-fishin e vlerës të tarifës së përcaktuar në aktet ligjore/nënligjore në fuqi.</p> <p>7. Personat fizikë që ushtrojnë qitjen sportive, kanë të drejtë të pajisen me jo më shumë se dy armë për çdo model, sipas përcaktimit të nenit 8 të këtij ligji</p> <p>8. Personat fizik të autorizuar si koleksionistë, kanë të drejtë të pajisen me jo më shumë se dy armë për çdo model sipas përcaktimit të nenit 8 të këtij ligji.</p> <p>9. Subjektet e shërbimit privat të sigurisë fizike, kanë të drejtë të blejnë me një autorizim armë dhe 50 fishekë për armët e shkurtra dhe 100 fishekë për armë të gjata.</p> <p>10. Armët e kategorive “B” dhe “C” sipas këtij ligji, të cilat i dhurohen shtetasve që plotësojnë kriteret e këtij ligji, regjistrohen dhe administrohen sipas akteve ligjore/nënligjore në fuqi.</p>		
<p>DIREKTIV ËN</p>			<p>Projektligji “Për disa shtesa dhe</p>	<p>Neni 33</p>	<p>Në nenin 39 bëhen këto ndryshime dhe shtesa:</p>	<p>Plotësisht i përputhur</p>	

<p>2017/853/K E TË PARLAME NTIT EVROPIA N DHE TË KËSHILLI T të datës 17 Maj 2012</p>	<p>Pa cenuar nenin 3, shtetet anëtare duhet të lejojnë blerjen dhe posedimin e armëve vetëm nga personat e licencuar ose, për sa i përket armëve të zjarrit të klasifikuara në kategorinë C, nga ata persona që janë veçanërisht të autorizuar për të blerë dhe poseduar këto armë zjarri në përputhje me legjislacionin kombëtar.";</p>		<p>ndryshime në ligjin nr. 74/2014 "Për armët"</p>		<p>1. Në titull pas fjalës "vetjak" shtohet "të armës".</p> <p>2. Pikat 1, 2 dhe 3 ndryshohen, si dhe shtohen pikat 4, 5, dhe 6 me përmbajtjen si vijon:</p> <p>"1. Subjektet e licensuara për tregtim u lejohe të shesin armët e zjarrit, pjesët e armës dhe municioneve, vetëm personave juridik dhe personave fizik të pajisur me autorizim të vlefshëm nga organi përgjegjës i policisë.</p> <p>1. Çdo transferim i mëtejshëm i armëve të zjarrit të kategorive "C", bëhet vetëm personave të pajisur me autorizim blerje nga komisioni përgjegjës, për këtë kategori armë zjarri në përputhje me legjislacionin në fuqi.</p> <p>2. Shitja e armës së zjarrit midis subjekteve fizik/juridik të pajisur me autorizim për mbajtje arme/licence dhe subjekteve me autorizim për blerje arme, bëhet me kontratë të vërtetuar tek noteri e cila përmban, llojin, markën, numrin e serisë dhe kalibrin e armës, të dhënat e personit shitës e blerës që përfshihen në autorizimin për mbajtjen e armës/licence dhe autorizimin e blerjes. Regjistrimi dhe çregjistrimi i armës së zjarrit bëhet brenda afatit të 5 ditëve në organin përgjegjës të policisë, në juridiksion teritorial, duke kryer edhe procedurat e dërgimit të formularit të balistikes nga organin përkatës i policisë vendore ne PolicinëShkencore.</p> <p>3. Këmbimi i armëve të zjarrit midis</p>		
---	--	--	--	--	--	--	--

<p>DIREKTIV ËN 2017/853/K E TË PARLAME NTIT EVROPIA N DHE TË KËSHILLI T të datës 17 Maj 2012</p> <p><i>Neni 5b</i></p>	<p>Shtetet anëtare duhet të garantojnë që, në rastet që përfshijnë blerjen dhe shitjen e armëve të zjarrit, pjesëve kryesore ose municioneve të klasifikuara në kategorinë A, B ose C përmes kontratave të shitjes në distancë të përcaktuara në pikën 7 të nenit 2 të Direktivës 2011/83/BE të Parlamentit Evropian dhe të</p>				<p>subjekteve fizik/juridik të pajisur me autorizim për mbajtje arme/licence kryhet, në organin e policisë vendore ku është regjistruar njera armë, duke deklaruar me shkrim nga dy pronarët pa akt noterial.Pas dorëzimit të deklarimeve kryejnë regjistrimin secili në organin përkatës të policisë vendore.</p> <p>4. Blerja e shitja e armëve të gjahut të kategorisë “C”, lejohet vetëm me autorizim brenda ose jashtë vendit. Shitja e armëve të gjahut një shtetasi të huaj, bëhet me kusht që blerësi të jetë i pajisur me autorizim dhe dokumente identifikuese, të përkthyerat e të noterizuara. Kur kryhet një transferim i tillë, organi përgjegjës i policisë përkatëse lëshon një leje transferimi. Kjo leje e shoqëron armën e gjahut deri në mbërritjen ne destinacion. Arma e zjarrit duhet të shoqërohet me një dokument, i cili përfshin të gjitha të dhënat e përmendura në pikën 3 të këtij neni.</p> <p>Për transferimin e armës njoftohet vendi pritës sipas adresës së autorizimit për blerje.</p> <p>5. Ndalohet shitblerja e armëve, pjesëve të armës dhe municionit përmes internetit.</p>	<p>Jo ne përputhje</p>	
---	---	--	--	--	---	------------------------	--

	<p>Këshillit*, identiteti, dhe kur është e nevojshme, autorizimi i blerësit të armës së zjarrit, pjesëve kryesore ose municionit kontrollohen përpara, ose të paktën menjëherë në momentin që i dorëzohen atij personi, nga:</p> <p>a)një tregtar ose ndërmjetës i licencuar ose autorizuar; ose</p> <p>b)një autoritet publik ose përfaqësuesi i atij autoriteti.</p>						
<p>DIREKTIV ËN 2017/853/K E TË PARLAME NTIT EVROPIA N DHE TË KËSHILLI T të datës 17 Maj 2012</p>	<p>Për të minimizuar rrezikun që armët e zjarrit dhe municionet të aksesohen nga persona të paautorizuar, vendet anëtare vendosin rregulla lidhur me mbikëqyrjen e duhur të armëve të zjarrit dhe municioneve, si</p>		<p>Projektligji “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 74/2014 “Për armët””</p>	<p>Neni 35</p>	<p>Në nenin 41 bëhen këto ndryshime dhe shtesa: 1. Pika 5 ndryshohet me formulimin si vijon: “5. Për të minimizuar rrezikun që armët e zjarrit dhe municionet të aksesohen nga persona të paautorizuar, subjektet që janë autorizuar të mbajnë armë, kanë detyrimin për mbikëqyrjen e duhur të armëve të zjarrit dhe municioneve, si dhe rregullave për ruajtjen e duhur në mënyrë të sigurt”. 2. Pas pikës 5 shtohen pikat 5.1, 5.2 dhe 5.3 si më poshtë:</p>	<p>Plotësisht i përputhur</p>	

Neni 5 a	<p>dhe rregulla për ruajtjen e duhur në mënyrë të sigurt. Armët e zjarrit dhe municionet e tyre nuk duhet të jenë lehtësisht të aksesueshme së bashku.</p> <p>Mbikëqyrje e duhur do të thotë që personi që disponon në mënyrë të ligjshme armën e zjarrit ose municionin në fjalë gëzon kontroll mbi të gjatë transportit ose përdorimit.</p> <p>Niveli i shqyrtimit të imtësishëm i këtyre masave të ruajtjes së duhur duhet të pasqyrojë numrin dhe kategorinë e armëve të zjarrit dhe municioneve në fjalë.</p>				<p>“5.1 Armët e zjarrit dhe municionet e tyre nuk ruhen të bashkuar, ato mbahen të ndara, arma e shkurtër ruhet me kyç bllokimi duke mos qenë lehtësisht të aksesueshme së bashku.</p> <p>5.2 Mbikëqyrje e duhur, do të thotë që personi që disponon në mënyrë të ligjshme armën e zjarrit ose municionin në fjalë, gëzon kontroll mbi të gjatë mbajtjes transportit ose përdorimit.</p> <p>5.3 Niveli i shqyrtimit të imtësishëm i këtyre masave të ruajtjes së duhur, duhet të pasqyrojë numrin dhe kategorinë e armëve të zjarrit dhe municioneve në fjalë”.</p> <p>3. Pas pikës 5 shtohet pika 6 me këtë përmbajtje:</p> <p>“6. Kriteret e sigurisë së armëve përcaktohen në rregullore të miratuar me Vendim të Këshillit të Ministrave”.</p>		
<p>DIREKTIV ËN 2017/853/K E TË PARLAME NTIT EVROPIA N DHE TË KËSHILLI</p>	<p>1. Predhat ushtarake plasëse dhe sistemet për lansim</p> <p>2. Armët e zjarrit automatike</p> <p>3. Armët e zjarrit të kamufluara si objekte të tjera</p>		<p>Projektligji “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 74/2014 “Për armët””</p>				

<p>T të datës 17 maj 2017</p> <p>Shtojca I</p> <p><i>Kategoria</i> A — Armët e ndaluara të zjarrit</p>	<p>4. Municioni me shkallë të lartë depërtuese, municioni me predha shpërthyes ose me predha ndezëse, si dhe predhat për një municion të tillë</p> <p>5. Municioni për pistoleta dhe revolverë me predhë shpërndarëse dhe hapëse si dhe predhat për një municion të tillë, përveç rasteve të armëve për gjueti ose atyre sportive të personave që kanë të drejtë t'i përdorin ato</p> <p>6. Armët e zjarrit automatike që janë konvertuar në armë zjarri gjysmëautomatike, pa cenuar nenin 7, paragrafi 4, germa "a".</p> <p>7. Secila nga armët e zjarrit gjysmëautomatike me ndezje qendrore, më poshtë: a) armë zjarri të shkurtra që shkrepin më shumë se 21 fishekë pa</p>			<p>Neni 4 Pika 1,2</p>	<p>“e) armë zjarri me zhurmëmbytës të montuar (A6); f) armë zjarri me tytë të vjaskuar me kalibër mbi 12.7 milimetra (A7); g) mjetet plasëse dhe pjesët e tyre (A8); h) armë për përdorim të agjentëve kimik dhe municioni i saj (A9); i) pajisja e veçantë për armë zjarri e cila mundëson ndryshimin e armës së zjarrit në kategori tjetër nga ajo origjinalja (A10); j) armë me elektroshok (paralizues elektrik) (A11); k) municioni blindshpues, gjurmëlënës, djegës (A12); l) armë e drejtuar me energji ADE (A13)”.</p> <p>2. Pas pikës 1 shtohen pikat 1.1/1, 1.1/2 dhe 1.1/3 me këtë përmbajtje: “1.1/1. Armët e zjarrit automatike që janë konvertuar në armë zjarri gjysmëautomatike: Secila nga armët e zjarrit gjysmë automatike me ndezje qendrore, më poshtë: a) armë zjarri të shkurtra që shkrepin më shumë se 21 fishekë pa rimbushje, nëse: i. mbushësi me kapacitet</p>	<p>Plotësisht në përputhje</p>	
--	---	--	--	----------------------------	---	--------------------------------	--

	<p>rimbushje, nëse: (i) një pajisje mbushëse me kapacitet mbi 20 fishekë është pjesë e armës së zjarrit; ose (ii) një pajisje mbushëse e çmontueshme me kapacitet mbi 20 fishekë futet në armën e zjarrit; b) armë zjarri të gjata që shkrepin më shumë se 11 fishekë pa rimbushje, nëse: (i) një pajisje mbushëse me kapacitet mbi 10 fishekë është pjesë e armës së zjarrit; ose (ii) një pajisje mbushëse e çmontueshme me kapacitet mbi 10 fishekë futet në armën e zjarrit.</p> <p>8. Armë zjarri të gjata gjysmëautomatike (p.sh. armët e zjarrit që fillimisht janë synuar të shkrepin mbi krah) të cilat mund të reduktohen në një gjatësi nën 60 cm pa humbur funksionalitetin,</p>				<p>mbi 20 fishekë është pjesë e kësaj arme zjarri; ose (A14);</p> <p>ii. mbushësi i çmontueshëm me kapacitet mbi 20 fishekë futet në armën e zjarrit (A15).</p> <p>b) armë zjarri të gjata që shkrepin më shumë se 11 fishekë pa rimbushje, nëse:</p> <p>i. mbushësi me kapacitet mbi 10 fishekë është pjesë e kësaj arme zjarri; ose (A16);</p> <p>ii. mbushësi i çmontueshëm me kapacitet mbi 10 fishekë futet në armën e zjarrit (A17).</p> <p>1.1/2. Armë zjarri të gjata gjysmë automatike të cilat mund të reduktohen në një gjatësi nën 60 cm pa humbur funksionalitetin me anë të një baze, me palosje ose teleskopike apo një baze që mund të hiqet pa përdorur vegla të tjera (A18).</p> <p>1.1/3. Çdo armë zjarri në këtë kategori që është konvertuar për të shkrepur fishekë manovre, substanca irrituese, substanca të tjera aktive ose fishekë piroteknikë, ose në armë të sinjalizimit akustik (A19)”.</p>		
--	--	--	--	--	--	--	--

	<p>me anë të një baze me palosje ose teleskopike ose një baze që mund të hiqet pa përdorur vegla të tjera.</p> <p>9. Çdo armë zjarri në këtë kategori që është konvertuar për të shkrepur fishekë manovre, substanca irrituese, substanca të tjera aktive ose fishekë piroteknikë ose armë të sinjalizimit akustik.';</p>						
<p>Kategoria B — Armët e zjarrit që i nënshtrohen autorizimit 1</p>	<ol style="list-style-type: none"> 1. Armë zjarri të shkurtra me përsëritje. 2. Armë zjarri të shkurtra për një qitje, me ndezje qendrore. 3. Armë zjarri të shkurtra me ndezje anësore, për një qitje, me gjatësi të përgjithshme deri në 28 cm. 4. Armë zjarri të gjata gjysmëautomatike, me pajisje mbushëse dhe 		<p>Projektligji “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 74/2014 “Për armët””</p>	<p>Neni 4 Paragrafi 1.2</p>	<p>“1.2. Armë zjarri të kategorisë “B” për të cilat kërkohet autorizim janë:</p> <ol style="list-style-type: none"> a) Armë zjarri të shkurtra me përsëritje (B1); b) Armë zjarri të shkurtra me një qitje, me ndezje qendrore (B2); c) Armë zjarri të shkurtra me një qitje, me ndezje anësore, me gjatësi të përgjithshme nën 28 cm (B3); d) Armët e zjarrit të gjata gjysmëautomatike me mbushës dhe fole, mund të mbajnë së bashku më shumë se 3 fishekë në rastin e armëve të zjarrit me ndezje anësore dhe më shumë se tre, por më pak se dymbëdhjetë fishekë në rastin e armëve të zjarrit me ndezje qendrore (B4); e) Armë zjarri të shkurtra 	<p>Plotësisht në përputhje</p>	

	<p>fole fishekësh që së bashku, mund të mbajnë më tepër se tre fishekë në rastin e armëve të zjarrit me ndezje anësore dhe më tepër se tre por më pak se dy mbledhjetë fishekë në rastin e armëve të zjarrit me ndezje qendrore.</p> <p>5. Armë zjarri të shkurtra gjysmëautomatike përveç atyre të renditura në pikën 7(a) të kategorisë A.</p> <p>6. Armë zjarri të gjata gjysmëautomatike, të renditura në pikën 7(b) të kategorisë A, me pajisje mbushëse dhe fole fishekësh që së bashku, mund të pranojnë deri në tre fishekë,</p>				<p>gjysmëautomatike që nuk janë përfshirë në pikën 1.1/1, germa “a” të kategorisë A (B5);</p> <p>f) Armë zjarri të gjata gjysmëautomatike të renditura në paragrafin 1.1/1, germa “b” të kategorisë A, me pajisje mbushëse dhe fole fishekësh që së bashku, mund të pranojnë deri në tre fishekë, kur mbushësi i tyre çmontohet ose kur nuk është e sigurt që këto armë mund të konvertohen, me mjete të zakonshme, në një armë mbushësi dhe foleja e fishekëve të së cilës pranojnë së bashku më tepër se tre fishekë(B6);</p> <p>g) Armë zjarri të gjata me përsëritje dhe gjysmëautomatike me tytë të pavjaskuar me gjatësi deri në 60 cm(B7);</p> <p>h) Çdo armë zjarri në këtë kategori që është konvertuar për të shkrepur fishekë manovre, substanca irrituese, substanca të tjera aktive ose fishekë piroteknikë ose në armë të sinjalizimit akustik(B8);</p> <p>i) Armët e zjarrit gjysmëautomatike për përdorim civil të ngjashme me armët me mekanizma automatikë, përveç atyre të renditura në pikat 1.1/1, 1.1/2 dhe 1.1/3 të kategorisë “A” (B9);</p> <p>j) Armët e zjarrit pneumatike, me</p>		
--	--	--	--	--	--	--	--

	<p>në rastin kur mbushësi i tyre mund të ndërrohet ose nëse nuk është e sigurt që këto armë nuk mund të konvertohen, me mjete të zakonshme, në një armë, mbushësi dhe foleja e fishekëve të së cilës pranojnë së bashku më tepër se tre fishekë.</p> <p>7. Armë zjarri të gjata me përsëritje dhe gjysmëautomatike me tytë të pavjaskuar me gjatësi deri në 60 cm.</p> <p>8. Çdo armë zjarri në këtë kategori që është konvertuar për të shkrepur fishekë manovre, substanca irrituese, substanca të tjera aktive ose fishekë</p>				<p>energji të predhës mbi 7,5 J dhe kalibër mbi 4,5 mm (B7)".</p>		
--	---	--	--	--	---	--	--

	<p>piroteknikë ose armë të sinjalizimit akustik.</p> <p>9. Armë zjarri gjysmëautomatike për përdorim civil të ngjashme me armët me mekanizma automatikë përveç atyre të renditura në pikat 6, 7 ose 8 të kategorisë A.;</p>						
<p>Kategoria C — Armët e zjarrit që i nënshtrohen deklarimit</p>	<ol style="list-style-type: none"> 1. Armë zjarri të gjata me përsëritje përveç atyre të renditura në pikën 7 të kategorisë B. 2. Armë zjarri të gjata me një qitje, me tytë të vjaskuar. 3. Armë zjarri të gjata gjysmëautomatike përveç atyre të renditura në kategorinë A ose B. 4. Armë zjarri të shkurtra me 		<p>Projektligji “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 74/2014 “Për armët””</p>	<p>Neni 4 Pika 1.3</p>	<p>“1.3.“Armë zjarri të kategorisë “C”, të cilat janë objekt deklarimi/autorizimi”, si më poshtë:</p> <ol style="list-style-type: none"> a) Armë zjarri të gjata me përsëritje që nuk janë përfshirë në germën “g”, të kategorisë “B” (C1); b) Armë zjarri të gjata me tytë të vjaskuar (C2); c) Armë zjarri të gjata gjysmëautomatike, që nuk janë përfshirë në kategorinë “A” ose “B” (C3); d) Armë zjarri të shkurtra me një qitje me ndezje anësore, me gjatësi të përgjithshme jo më pak se 28 cm(C4); e) Çdo armë zjarri në këtë kategori që është konvertuar për të shkrepur fishekë manovre, substanca irrituese, substanca të tjera aktive ose 	<p>Plotësisht në përputhje</p>	

	<p>një qitje me ndezje anësore, me gjatësi të përgjithshme jo më pak se 28 cm.</p> <p>5. Çdo armë zjarri në këtë kategori që është konvertuar për të shkrepur fishekë manovre, substanca irrituese, substanca të tjera aktive ose fishekë piroteknikë ose armë të sinjalizimit akustik.</p> <p>6. Armët e zjarrit të klasifikuara në kategorinë A ose B ose në këtë kategori, të cilat janë çaktivizuar, në përputhje me Rregulloren Zbatuese (BE) 2015/2403.</p> <p>7. Armë zjarri të gjata me një qitje me tytë të pavjaskuar të vendosura në</p>				<p>fishekë piroteknikë ose në armë të sinjalizimit akustik (C5);</p> <p>f) Armët e zjarrit të klasifikuara në kategorinë “A” ose “B” ose në këtë kategori, të cilat janë çaktivizuar, në përputhje me standardet dhe teknikat e çaktivizimit të miratuara me rregullore.</p> <p>g) Armët e zjarrit të gjata me një qitje me tytë të pavjaskuar (C7);</p> <p>h) Armët pneumatike me energji të predhës deri në 7,5 J dhe kalibër deri 4,5 mm (C8)”.</p>		
--	---	--	--	--	--	--	--

	<p>treg më ose pas datës 14 shtator 2018.';</p> <p>III. Për qëllimet e kësaj shtojce, objektet që i korrespondojnë përkufizimit të një "arme zjarri" nuk do të përfshihen në këtë përkufizim nëse:</p> <p>a) janë projektuar për alarmin, sinjalizimin, shpëtimin e jetës, therjen e kafshëve ose peshkimin me fuzhnjë ose për qëllime industriale ose teknike, me kusht që të përdoren vetëm për qëllimin e cituar;</p> <p>b) konsiderohen si armë antike kur këto nuk janë përfshirë në kategoritë e përcaktuara në pjesën II dhe janë objekt i ligjeve kombëtare.</p> <p>Ndërkohë që janë në pritje të koordinimit në të</p>			<p>Neni 3 Pika 2 a, b</p>	<p>c) është projektuar për alarmimin, sinjalizimin, shpëtimin e jetës, therjen e kafshëve ose peshkimin me fuzhnjë, ose për qëllime industriale e teknike, me kusht që të përdoren vetëm për qëllimin e cituar;</p> <p>d) konsiderohet si armë antike kur nuk është përfshirë në kategoritë e përcaktuara në nenin 5 të këtij ligji”.</p>		
--	---	--	--	-------------------------------	---	--	--

	gjithë BE-në, vendet anëtare mund të zbatojnë legjislacionet e tyre të brendshme të renditura në këtë pjesë.						
SHTOJCA II	LEJA EVROPIANE E ARMËVE TË ZJARRIT					Nuk parashikohet	